

# **DEKLARATË**

## **KUNDËR GJUHËS SË URRJETJES NË MEDIUME DHE INTERNET**

Duke KONFIRMUAR si universale dhe të pandashme të të drejtave të njeriut dhe të domosdoshme për garantimin dhe respektimin nga të gjithë faktorët në shtet,

Duke KUJTUAR se lira e shprehjes dhe qasja tek informacionet janë të drejta themelore të njeriut,

Duke PATUR PARASYSH se lira e shprehjes mund të pësojë kufizime të caktuara ligjore të domosdoshme për një shoqëri demokratike, në mënyrën siç është konstatuar në Nenin 10, paragrafi 2 nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut,

Duke THEKSUAR rëndësinë e jashtëzakonshme të mediumeve në funksionimin e shoqërisë demokratike dhe në promovimin e të drejtave të njeriut.

TË PËRKUSHTUAR në parimet e informimit etik dhe profesional të publikut, të pavarësisë redaktuese të mediave dhe mospranimin e censurës, dhe

TË VETËDIJSHËM se lufta kundër gjuhës së urrejtjes në shoqëri duhet të bazohet me një gjithëpërfshirje që adreson shkaqet shoqërore, ekonomike, politike, kulturore si dhe shkaqet e tjera të kësaj dukurie.

Nënshkruesit e kësaj Deklarate, përfaqësues të shoqatave të mediave dhe gazetarëve, vendimmarrësit, organet rregulluese shtetërore kompetentë për mbrojtje të drejtave të njeriut, organizatat nga sektori civil, subjektet arsimore dhe hulumtuese nga fusha e mediumeve dhe mbrojtje të lirisë së të shprehurit dhe të drejtat e njeriut, ranë dakord për këtë si vijon:

1. Të formohet Rejt kundër gjuhës së urrejtjes në mediume dhe internet, qëllimi kryesor i së cilit është parandalimi dhe përhapja e gjuhës së urrejtje në sferën publike, fuqizimin e veprimtarisë profesionale dhe etike të gazetarisë, ngritjen e vetëdijes së popullatës më të gjerë nga pasojat negative nga gjuha e urrejtjes.



2. Anëtarët e Rrjetit, në kuadër të kompetencave të tyre dhe programit të punës që kanë, do të angazhohen për përcjellje të vazhdueshme dhe të koordinuar për avancimin e efikasitetin e kornizës ligjore të vendit në aspekt të parandalimit dhe përhapjes së gjuhës së urrejtje në sferën publike.
3. Rrjeti në vazhdimësi do të punojë për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për mbrojtje nga pasojat e gjuhës së urrejtje në sferën publike dhe të promovimit të informimit publik të pavarur, profesional dhe etik, të liruar nga gjuha diskriminuese dhe paragjykimeve, gjuhës së urrejtje në cilën do bazë, si dhe gjuhë që provokon ose nxit urrejtje dhe dhunë.
4. Rrjeti do të iniciojë dhe nxisë zbatimin e aktiviteteve edukative me qëllim të rriten njohuritë dhe kuptimi i gazetarëve dhe punonjësve mediatike për mënyrat sesi përdoret gjuha e urrejtjes dhe implementimeve të tyre, si dhe mënyrat për parandalimin e saj.
5. Rrjeti do të punojë në zhvillimin e mekanizmave për detektimin dhe denoncimin e rasteve të gjuhës së urrejtje tek organet kompetente, me qëllim të parandalohet përhapja e mëtutjeshme në sferën publike dhe pasojat e dëmshme në shoqëri.
6. Anëtarët e Rrjetit do të punojnë, në kuadër të kompetencave dhe mundësive, të zhvillimit të formave për përkrahje dhe mbrojtje të gazetarëve dhe përfaqësueseve të mediumeve, ndaj të cilëve është drejtuar gjuha e urrejtjes.
7. Rrjeti vazhdimisht do të angazhohet për afirmimin e rolit të mediumeve, por edhe për provajderët e shërbimeve të rrjeteve sociale në parandalimin e gjuhë së urrejtjes dhe në edukimin dhe mënyrat e detektimit të gjuhës së urrejtjes dhe demaskimit të saj.
8. Rrjeti do të punojë në mënyrë të koordinuar për në iniciimin e programeve, mekanizmave të vetë-rregullimit dhe kodekseve të tjera interne të provajderëve të shërbimeve, si dhe masave të tjera parandalueseve, me të cilat do të pengohet përdorimin i gjuhës së urrejtjes në sferën publike, duke mos u cenuar e drejta e lirës së shprehjes.

